



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL-Anr.38/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj, kryesuese Arsim Hamzaj, dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Darko Vukašinović nga Leposaviq, kandidat për anëtar për Zgjedhjet Lokale, në Leposaviq, nga Subjekti Politik “Za Slobodu, Pravdu i Opstanak”, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos decertifikimit nga lista për kandidat për anëtar në Zgjedhjet Lokale 2025, si kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Leposaviq, në seancën e panelit të mbajtur me 17.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa Anr.38/2025 e datës 17.09.2025, e parashtruar nga Darko Vukašinović nga Leposaviq, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Leposaviq, nga Subjekti Politik “Za Slobodu, Pravdu i Opstanak”, parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos decertifikimit nga lista për kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 15.09.2025 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Darko Vukašinović nga Leposaviq, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Leposaviq, i cili ka kërkuar që të tërhiqet nga gara pasi që i njëjti është i punësuar në institucion publik si zyrtar financiar, duke e kryer periudhën provuese në kohëzgjatje prej 6 muajve.

Parashtruesi ka bashkangjitur si dëshmi në ankesë në PZAP me të cilën ka kërkuar tërheqjen nga kandidatura.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka dërguar përgjigjen në ankesë më datën 15.09.2025, në të cilën theksohet se pas përfundimit të gjithë procesit të certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre, hapi i radhës është mbajtja e tërheqjes së shortit me ç’rast të gjitha subjektet

politike të certifikuara tërheqin numrat e tyre me të cilët do të radhiten në fletëvotim. Tutje kane shtuar se të gjitha kërkesat për tërheqje të subjekteve politike apo kandidatëve, pranohen dhe trajtohen përderisa arrijnë në Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar, deri në dy (2) ditë para ditës së caktuar për tërheqje të shortit, sic përcaktohet me nenin 29 të LZP.

Kandidatët e subjektit politik “Za Slobodu, Pravdu i Opstanak”, janë certifikuar me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me numër 01/2222-2025 të datës 21.08.2025.

Zyra ka pranuar një numër të kërkesave për tërheqje nga kandidatët e certifikuar të subjekteve të ndryshme politike të cilat janë trajtuar dhe Zyra ka rekomanduar KQZ për decertifikimin e këtyre kandidatëve. Siç u theksua më lartë, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 29 të LZP, kërkesat për tërheqje nga procesi zgjedhor bëhen duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim me të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për zgjedhje. Kane theksuar se në përputhje me Planin Operacional për Zgjedhjet Lokale 2025, data e caktuar për tërheqjen e shortit është caktuar 4 Shtator 2025.

Për më tepër, me datën 06.09.2025 përmbajtja e fletëvotimeve është aprovuar nga KQZ që nënkupton se nga momenti i aprovimit të përmbajtjes së fletëvotimit, çfardo ndryshimi në fletëvotim është i pamundshëm, nisur nga fakti që fillon faza e fundit e që është procesi i printimit të fletëvotimeve..

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas vlerësimit të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga kandidati për anëtar në Komunën e Leposaviqit nga radhët e Subjekti Politik “Za Slobodu, Pravdu i Opstanak” është e pa bazuar.

Sipas pretendimeve ankimore të parashtruesi i ankesës, dhe Subjekti Politik “Za Slobodu, Pravdu i Opstanak” konkludohet se nuk kanë vepruar bazuar në nenin 29.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, e konstaton edhe vet parashtruesi i ankesës në ankesën e tij drejtuar në PZAP, ku ndër të tjera thuhet se *“Unë Darko Vukašinić kandidat për anëtar nga subjekti politik “Za Slobodu, Pravdu i Opstanak”, për shkak që nuk kam dëshirë që të më ngrihet pozita ime e punës si zyrtar financiar, dëshiroj të tërheqë kandidaturën time si kandidat për anëtar për zgjedhjet lokale...”*.

Andaj Paneli ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e pa bazuar pasi që në nenin 29 par. 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mënyrë decisive thuhet se : *“Subjekti politik i certifikuar mund të tërhiqet nga procesi zgjedhor duke i dorëzuar KQZ-së një njoftim me shkrim me të cilin shpreh qartazi qëllimin për tërheqje jo më vonë se dy (2) ditë të punës para datës së caktuar për hedhje të shortit për zgjedhje, të përcaktuar sipas nenit 25.1 të këtij ligji.”* Në këtë rast KQZ-ja e ka tërhequr shortin për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim me datë 04.09.2025, ndërsa parashtruesi i

ankesës, me ankesë nuk ka dorëzuar në PZAP prova materiale se ka dorëzuar deri me datë 02.09.2025, shkresë në KQZ për tërheqje nga lista si kandidat për anëtar i Kuvendit Komunal në Komunën e Leposaviqit, që rezulton se parashtuesi i ankesës, dhe Subjekti Politik “Za Slobodu, Pravdu i Opstanak” nuk kanë vepruar bazuar në nenin 29, paragrafit 1 të LZP-së.

Në nenin 117.3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mënyrë decitive thuhet se : *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.”*

Në nenin 118.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mënyrë decitive thuhet se : *“PZAP-ja pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht.”*

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.A.nr. 38/2025 më datën 17.09.2025.



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.